




REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	2-D
Dep.	
Dep.	
Nr. I faq. Broj stranica Nr. pages	06
Nr. Prot. Br. Prot. Prot No.	01-3600/13
Data Datum Date	29.10.2013
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

**AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY**

**KODI NR. 03/2013 I ETIKËS
PËR NËPUNËSIT E AGJENCISË KUNDER KORRUPSIONIT**

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit, (Gazeta Zyrtare nr. 65, datë 05.02.2010), Drejtori i Agjencisë kundër Korruptionit, nxjerr:

KODI NR. 03/2013 I ETIKËS PËR NËPUNËSIT E AGJENCISË KUNDËR KORRUPTIONIT

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

**Neni 1
Qëllimi**

1. Kodi i Etikës për nëpunësit e Agjencisë kundër Korruptionit (në tekstin e mëtejmë Kodi) përmban tërësinë e parimeve dhe normave mbi bazën e të cilave veprojnë nëpunësit e Agjencisë kundër Korruptioni (në tekstin e mëtejmë Agjencia).
2. Kodi ka për qëllim të vendosë rregullat e sjelljes për nëpunësit e Agjencisë, në ushtrimin e detyrave në Agjenci dhe jashtë saj, promovimin dhe mbrojtjen e statusit të tyre si dhe rregullimin e të drejtave dhe detyrave të tyre në raport me institucionet dhe publikun në pajtim me legjislacionin në fuqi.
3. Kodi do të promovoje shërbimin e nëpunësve të Agjencisë, etikën e punës dhe interesin publik bazuar në parimin e ligjshmërisë, integrititetit, ndershmërisë, objektivitetit dhe paanshmërinë në përbushjen e detyrave.

**Neni 2
Fushëveprimi**

Dispozitat e Kodit zbatohen ndaj të gjithë nëpunësve të Agjencisë si dhe ndaj personave të angazhuar për kryerjen e shërbimeve të veçanta për Agjencinë.

**Neni 3
Përkufizimet**

Shprehjet e përdorura në ketë Kod kanë këto kuptime:

1. **Agjencia kundër Korruptionit.** Në pajtim me nenin 3 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit, Agjencia është organ i pavarur dhe i specializuar për zbatimin e politikave shtetërore për parandalimin dhe luftimin e korruptionit në Kosovë dhe veprimtarinë e saj e ushtron në pajtim me legjislacionin në fuqi.

- 2. Komisioni i Etikës.** Organ i cili themelohet në kuadër të Agjencisë kundër Korrupsionit dhe është përgjegjës për zhvillimin e procedurave dhe rekomandon caktimin e masave për shkelje të etikës nga nëpunësit e Agjencisë.
- 3. Nëpunësit e Agjencisë kundër Korrupsionit.** Personat e punësuar për ushtrimin e autoritetit administrativ publik në kuadër të Agjencisë.
- 4. Fjalët e një gjinie të përdorura në këtë Kod përfshijnë edhe gjininë tjetër.**

Neni 4

Parimet e përgjithshme të Kodit të Etikës për nëpunësit e Agjencisë

Nëpunësit e Agjencisë duhet t'i përmbushin detyrat e tyre mbi bazën e kätyre parimeve:

- 1. Parimi i ligjshmërisë.** Nëpunësit e Agjencisë kryejnë detyrat në pajtim me Kushtetutën, ligjin dhe aktet nënligjore në fuqi. Nëpunësit duhet të kryejnë punët dhe detyrat për të cilat kanë kompetencë dhe autoritet ligjor, brenda kufijve të kompetencave që i janë dhënë Agjencisë dhe në pajtim me qëllimin për të cilin është themeluar.
- 2. Parimi i barazisë dhe i mos diskriminimit.** Nëpunësit e Agjencisë respektojnë dinjitetin dhe barazinë e kolegëve të Agjencisë dhe palëve të ndërlidhura me funksionet e tyre, pa asnjë dallim dhe diskriminim. Agjencia bënë trajtimin e barabartë te të gjithë personave fizikë dhe juridikë pavarësisht nga dallimi i tyre në bazë të: gjinisë, racës, ngjyrës, besimit, gjuhës, orientimit politik ose përkatësisë tjetër, origjinës kombëtare ose sociale ose ndonjë statusi tjetër.
- 3. Parimi i neutralitetit politik.** Zyrtarët e Agjencisë duhet të veprojnë në mënyrë të pavarur nga pikëpamjet e tyre politike në atë mënyrë që të mos pengojnë zbatimin e politikave, të vendimeve ose të veprimeve ligjore të Agjencisë.
- 4. Parimi i veprimit në interes të përgjithshëm.** Të gjithë zyrtarët e Agjencisë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, duhet të ruajnë interesin e përgjithshëm, madje duke ruajtur edhe dinjitetin e personave të cilët i nënshtrohen hetimit.
- 5. Parimi i paanshmërisë dhe pavarësisë.** Nëpunësit e Agjencisë i kryejnë detyrat e tyre pa u ndikuar nga interesat private ose personale. Puna e nëpunësve të Agjencisë nuk ndikohet nga paragjykimet e zyrtarëve që e ushtrojnë këtë veprimtari.
- 6. Parimi i ndershshmërisë procedurale.** Nëpunësit e Agjencisë gjatë punës së tyre në mënyrë të ndershme duhet të përfillin procedurën për zbatimin e ligjit për të respektuar vlerat dhe dinjitetin e personave tjera.
- 7. Parimi i respektit.** Nëpunësit e Agjencisë duhet të jenë të sjellshëm në marrëdhëniet me qytetarët, me udhëheqësit, kolegët dhe vartësit e tyre në vendin e punës dhe jashtë Agjencisë gjatë dhe pas orarit të punës.

8. **Parimi i përdorimit racional të mjeteve financiare publike.** Nëpunësit e Agjencisë gjatë punës së tyre demonstrojnë racionalitet në menaxhimi e mjeteve financiare, duke mos penguar në asnjë rrëthanë efikasitetin e punës së Agjencisë gjatë realizimit të misionit të saj.
9. **Parimi i shmangjes së konfliktit të interesit.** Nëpunësit e Agjencisë nuk duhet të lejojnë që interesat e tyre private të bien ndesh me pozitën e tyre publike, të shmangin konfliktin e interesit dhe të mos shfrytëzoj asnjëherë pozitën për interesat e tyre private. Nëpunësit e Agjencisë kanë për detyrë të deklarojnë çdo interes privat në lidhje me detyrat e tyre dhe të ndërmarrin hapa për të mbrojtur interesin publik.
10. **Parimi i transparencës.** Nëpunësit e Agjencisë punën e tyre e zhvillojnë mbi bazën e parimit të transparencës ndërsa bëhet publike brenda suazave të përcaktuara me dispozitat ligjore.
11. **Parimi i konfidencialitetit.** Të gjithë nëpunësit e Agjencisë janë të obliguar që informatat e ndjeshme të cilat i mësojnë gjatë punës së tyre t'i ruajnë si konfidenciale në pajtim me legjislacionin në fuqi.
12. **Parimi i komunikimit.** Komunikimi me palë bëhet në ambientet e institucioneve, telefonit zyrtar dhe përmes adresës zyrtare elektronike.
13. **Parimi i mospranimit të dhuratave ose përfitimeve tjera.** Nëpunësit e Agjencisë nuk duhet të kërkojnë ose pranojnë dhurata ose përfitime tjera materiale dhe jo materiale nga palët, për veten, familjen ose të afërmit të cilat vejnë në pyetje pavarësinë, paanshmërinë, dhe integritetin e Agjencisë.
14. **Parimi i profesionalizmit.** Nëpunësit e Agjencisë duhet të demonstrojnë standardet më të larta profesionale që përmes praktikave të mira mundësojnë kryerjen e punëve në mënyrë kualitative.

Neni 5

Autorizimet dhe kompetencat

1. Nëpunësit e Agjencisë janë të autorizuar që gjatë orarit të punës dhe kohës që ndërlidhet me orarin e punës, të ushtrojnë kompetencat e përcaktuara me ligjin në fuqi.
2. Nëpunësit e Agjencisë duhet që:
 - 2.1. Të zbatojnë ligjet në mënyrë korrekte në pajtim me autorizimet e dhëna;
 - 2.2. Të veprojnë në mënyrë jo diskriminuese;
 - 2.3. Të reflektojnë pavarësi nga ndikimet politike;
 - 2.4. Të mbrojnë interesin e përgjithshëm;
 - 2.5. Gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare të tregojnë integritet dhe paanshmëri;
 - 2.6. Të respektojnë procedurat e parapara me legjislacionin në fuqi;
 - 2.7. Të reflektojnë kulturë, edukatë dhe etikë;
 - 2.8. Të shpenzojnë buxhetin në mënyrë racionale;

- 2.9. Të shhangin konfliktin e interesit;
- 2.10. Të veprojnë në mënyrë transparente;
- 2.11. Të ruajnë informacionet që i mësojnë gjatë punës së tyre;
- 2.12. Të mos realizojnë takime jashtë ambientit të institucioneve;
- 2.13. Të mos pranojnë dhurata ose përfitime tjera që ndërlidhen me ushtrimin e detyrave të tyre;
- 2.14. Të përgatiten dhe ngriten profesionalisht.
- 2.15. Të respektojnë rregullat tjera për çështjet që lidhen me Kodin e Etikës dhe të ndërmarrin edhe vepime tjera të ndërlidhura me funksionet dhe kompetencat e tyre.

Neni 6
Mbikëqyrja e zbatimit të Kodit të Etikës

1. Mbikëqyrjen e zbatimit të Kodit të Etikës për nëpunësit e Agjencisë në vazhdimësi do ta bëj Komisioni i Etikës në kuadër të Agjencisë.
2. Zyra e Personelit obligohet që t'ia bëj të ditur nëpunësit me rastin e punësimit të tij detyrimet që burojnë nga Kodi i Etikës të cilat duhet të respektohen nga nëpunësi i Agjencisë. Njoftimi i njëjtë duhet të behet edhe për nëpunësit e Agjencisë para hyrjes në fuqi të këtij Kodi.
3. Dispozitat e këtij Kodi janë pjesë e kushteve të punësimit. Shkelja e tyre përbën shkak përmarrjen e masave në rast se veprimet nuk përbëjnë shkelje disiplinore ose vepër penale.
4. Udhëheqësi i drejtpërdrejtë i nëpunësit ka përgjegjësi të kontrolloj nëse nëpunësi zbaton rregullat e sanksionuara në këtë Kod dhe të propozoj masat.

Neni 7
Komisioni i Etikës

1. Secili nëpunës i Agjencisë ka të drejtë të denoncojë apo raportojë për rastet e shkeljes së dispozitave të këtij Kodi;
2. Drejtori i Agjencisë formon Komisionin e Etikës prej tre (3) anëtarësh të cilët zhvillojnë procedurën për shkelje të Kodit të Etikës dhe i rekomandojnë atij për caktimin e masës përkatëse.
3. Përbërja e Komisionit të Etikës bëhet sipas specifikave të çdo rasti konkret.

Neni 8
Masat për shkeljet e dispozitave të Kodit të Etikës

1. Masat për shkeljen e dispozitave të këtij Kodi janë:

- 1.1. Vërejtje me gojë
- 1.2. Vërejtje me shkrim;

2. Për vendimet e marra për rastet e shkeljes së këtij Kodi, njoftohen të gjithë nëpunësit e Agjencisë.

3. Për të gjithë nëpunësit ndaj të cilëve janë caktuar dy masa brenda vitit sipas këtij Kodi, iniciohet procedura disiplinore.

4. Zyra e Personelit mban evidencë për rastet dhe masat e caktuara për shkelje të këtij Kodi.

Neni 9
Dispozitat përfundimtare

Për çështjet që nuk janë rregulluar shprehimisht me këtë Kod dhe që kanë të bëjnë me etikën e nëpunësve të Agjencisë, Drejtori i Agjencisë rezervon të drejtën që t'i rregullojë ato, duke nxjerrë vendime të veçanta të cilat bëhen pjesë e këtij Kodi.

Neni 10
Publikimi i Kodit

Kodi i Etikës për nëpunësit e Agjencisë publikohet në ueb faqen zyrtare të Agjencisë pas miratimit.

Neni 11
Rishikimi i Kodit

Rishikimi i Kodit bëhet me propozimin e udhëheqësve të njësive organizative dhe me vendim të Drejtorit të Agjencisë.

Neni 12
Hyrja në fuqi

Ky Kod hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hasan PRETENI

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

Prishtinë, datë 28/10/2013.

